

FJALA E DEPUTETES OLTA XHAÇKA

E ENJTE 17 MARS 2022

E nderuar zonja Kryetare e Kuvendit,

Të nderuar kolegë,

Gjej rastin ta përgëzoj Këshillin Kombëtar për Integrimin Europian për kryerjen gjatë një viti me përpikëri të rolit që ligji “Për rolin e Kuvendit në procesin e integritit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Europian” i ka ngarkuar, atë të strukturës më të lartë këshillimore kombëtare për integrimin europian, si një instrument i rëndësishëm për të siguruar një qasje gjithëpërfshirëse dhe ndërgjegjësuese lidhur me reformat në procesin e integritit europian të Shqipërisë. Raporti 1-vjeçar i aktivitetit të Këshillit Kombëtar të Integritit Europian pasqyron, në fakt, gjithë atë punë madhore që është bërë përgjatë vitit 2021 nga qeveria shqiptare, nga strukturat negociuese për negociatat e aderimit dhe nga administrata që punon për çështjet e integritit europian. Kjo nënkupton të gjitha fushat, ombrellë e të cilave është integrimin europian i Shqipërisë, përgatiten për negociatat, zbatimin e ndihmës financiare të paraaderimit në Bashkimin Europian, zbatimin e agjendës së Stabilizim-Asocimit dhe të Planit Kombëtar të Integritit Europian dhe ngritjen e marrëdhënieve me Bashkimin Europian në nivel partneriteti në raste krizash e çështjesh madhore të përbashkëta të përfshira në kuadër të politikës sonë të jashtme dhe të sigurisë.

Të nderuar kolegë, gjatë vitit 2021 kemi marrë disa vlerësime të njëpasnjëshme nga Komisioni Europian, si dhe nga Këshilli i Bashkimit Europian në dhjetor të vitit 2021, se Shqipëria i ka përmbushur të gjitha kushtet për të nisur negociatat e anëtarësimit, çka pritet të bëhet nëpërmjet Konferencës së parë Ndërqeveritare ndërmjet Bashkimit Europian dhe Shqipërisë. Kjo flet më shumë se çdo gjë tjetër për përpjekjet dhe arritjet e Shqipërisë në këtë proces se çdo retorikë politike që, për fat të keq, e përdor politikën e jashtme për të fituar pikë në politikën e brendshme. Më tej, edhe për t’iu përgjigjur disa prej gjërave që u thanë këtu, siç e kam sqaruar dhe në Këshillin Kombëtar të Integritit Europian, edhe në Komisionin e Integritit Europian qeveria e ka bërë planin për adresimin e rekomandimeve të raportit të Komisionit Europian. Ai quhet Plani Kombëtar i Integritit Europian 2022-2024 dhe Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme e ka udhëhequr procesin e hartimit të këtij plani, i cili në përcaktimin e masave legislative dhe zbatuese është orientuar nga rekomandimet e raportit të fundit të Komisionit Europian. Këtë mund ta shihni qartë në secilin prej kapitujve të Planit Kombëtar për Integrimin Europian.

Sa i përket atij që u quajt “Plani për përmbushjen e kushteve për fillimin e negociatave” nuk po ju jap mendimin dhe qëndrimin tim apo të qeverisë, por po ju lutem të lexoni raportet e njëpasnjëshme të Komisionit Europian, por edhe qëndrimet e të gjitha vendeve anëtare, edhe atyre më kërkuese, të cilat thonë se Shqipëria i ka përmbushur kushtet për fillimin e negociatave të përcaktuara në Këshillin e marsit 2020. Nëse flasim për prioritetet e tjera të identifikuar nga Këshilli, në mars 2020, domethënë ato që do të përmbajë në të ardhmen kuadri negociues i Bashkimit Europian, pra prioritetet që do të duhet të përmbushen përgjatë procesit të negociatave, për këto prioritetet qeveria e ka bërë

planifikimin, ato janë pjesë e Planit Kombëtar për Integrimin European. Siç jeni të gjithë të njohur, siç u tha edhe këtu, për shkak të një artifice të krijuar nga një mosmarrëveshje mes dy fqinjëve të Shqipërisë, ky proces po mban pezull edhe vendimmarrjen për Shqipërinë në Këshill. Me të dyja vendet, qoftë me Maqedoninë e Veriut, qoftë me Bullgarinë Shqipëria gëzon marrëdhënie dypalëshe të shkëlqyera reciprokisht.

Gjithmonë kemi lobuar që mosmarrëveshjet dypalëshe të mos e pengojnë avancimin e vendeve kandidatë në rrugëtimin e tyre drejt Bashkimit European, kemi lobuar përherë që perspektiva e integritit të vendeve të Ballkanit Perëndimor të jetë e qartë dhe konkrete dhe procesi të jetë i besueshëm dhe i parashikueshëm. Siç e përmendi më herët edhe zoti Balla, jemi në një moment kyç për ta avancuar kërkesën tonë për mbajtjen sa më shpejt të Konferencës së parë Ndërqeveritare me Shqipërinë dhe me Maqedoninë e Veriut, mundësisht brenda termit të presidencës franceze të Këshillit të Bashkimit European. Ashtu siç ky Kuvend, ky parlament, e ka përjetuar këtë moment tejet delikat gjeopolitik në Europë, ku, në fakt, dy botëkuptime të ndryshme vlerash dhe parimesh po përballen dhe një vend i pafajshëm, vetëm sepse guxoi të zgjedhë të ardhmen e vet, po vuan nën breshërinë e bombave dhe bota, do të thosha, ka mbajtur frymën nga krimet e pakuptimta që po kryhen në Ukrainë prej agresorit rus në këtë përballje madhore, por, në fakt edhe shumë më herët, ashtu si ne kishim paralajmëruar, rajoni i Ballkanit Perëndimor është teatri i dytë më i rëndësishëm i pasojave të këtij konflikti.

Kemi parë se si rajoni është përçarë, kemi parë një influencë të jashtëzakonshme ruse në rajon, kemi parë se si pikat e dobëta në rajon janë ato që nuk kanë një perspektivë të qartë europiane, kemi parë se si forca e marrëdhënies kontraktuale me Bashkimin European apo forca e bashkëpunimit rajonal janë forca të fuqishme që ndalin konflikte, pavarësisht ndasive, prandaj më shumë se kurrë sot e në këtë kohë sfidash do të duhet të kërkojmë me forcë që politika e zgjerimit me vendet e Ballkanit Perëndimor të rikthehet në vëmendjen e Bashkimit European, sepse kjo politikë zgjerimi është një policë sigurimi, në fakt, për Bashkimin European në radhë të parë dhe së dyti për vetë rajonin, i cili ende nuk i ka të shëruara plagët e të shkuarës së vet të afërt.

Të nderuar kolegë, përtej rolit koordinues dhe monitorues të Kuvendit të Shqipërisë në këtë proces vital për vendin tonë, ky Kuvend i nderuar ka një rol lobues të jashtëzakonshëm. Fakt për këtë janë jo vetëm vizitat tuaja të shpeshta në vendet europiane, por edhe një hallkë shumë e rëndësishme e dialogut politik të agjendës së stabilizim-asocimit, që është Komiteti Parlamentar i Stabilizim-Asocimit. Gjej rastin këtu t'ju falënderoj për miratimin e konkluzioneve të komitetit të shkurtit 2022, që do të jenë edhe udhërrëfyese ynë për vitin në vazhdim. Qeveria shqiptare, unë, personalisht, në këtë detyrë, edhe në emër të strukturës negociuese, mbetemi plotësisht të përkushtuar për të realizuar çdo detyrim që na lind në procesin e integritit european të Shqipërisë, në përgatitje të bisedimeve të ardhshme për anëtarësim. Si zëri i mbështetjes mbarëqytetare për Shqipërinë në Europë, gjej rastin t'ju konfirmoj angazhimin e qeverisë shqiptare për të bashkëpunuar ngushtësisht me ju në rrugëtimin tonë drejt BE-së, në mënyrë që të realizojmë objektivin madhor të të gjitha qeverive në 30 vjetët e fundit në Shqipëri: atë të anëtarësimit në Bashkimin European. Faleminderit!